



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

P Ë R

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN
E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN
E PROJEKTIT “HEKURUDHAT SHQIPTARE - REHABILITIMI
I LINJËS HEKURUDHORE TIRANË - DURRËS DHE NDËRTIMI
I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN
NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, RATIFIKUAR
ME LIGJIN NR.29/2017”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, ratifikuar me

ligjin nr.29/2017”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I FINANCAVE

PETRIT MALAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2024

PËR

RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE
TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “HEKURUDHAT
SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE
TIRANË - DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE
PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.29/2017

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, ratifikuar me ligjin nr.29/2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

ELISA SPIROPALI